



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 630/2 prot:

Pukë, më 25.03.2024

VENDIM

Nr 09 date 18.03.2024

Per miratimin e listes se kullotave te gatshme per kullotje dhe kositje per vitin 2024.

Keshilli i Bashkise Puke ne mbledhjen e radhes se dates **18.03.2024**

Ne zbatim te nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1,2, germa "a", meni 54, germa "e", neni 55 pika 4 te ligjit nr. 139/2015, date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen Vendore"; Ligji nr. 57/2020 "Per Pyjet; Ligji nr. 49/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor" i ndryshuar; VKM nr. 433, date 08.06.2016 "Per transferimin sipas listave te inventarit te pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht ne administrimin e Ministirise se Mjedisit dhe ish Komunave/Bashkive ne pronesi te Bashkive, pika 50; VKM nr. 632, date 11.06.2009, "Per miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje. Udhezimit te Ministrise se Mjedisit nr. 2, date 20.07.2016 "Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave e livadheve dhe procedurat dhe dhenien e tyre per kullotje e kositje bari", Kreu II, pika 2 per miratimin e listes se kullotave te gatshme;

Me propozim te Kryetarit te Bashkise; Keshilli i Bashkise pas shqyrtimit:

VENDOSI

1. Miratimin e listes se kullotave te gatshme per kullotje e kositje sipas listes dhe hartave bashkengjitur ekonomine pyjore "Dush" ngastra/nengastrat 58/c, 61/c sip. totale 16.14 ha. Ekonomia pyjore "Gjegjan-Shkoze" ngastra 49/c sip. totale 6 ha. Ekonomia pyjore "Terbun" nr. 12/b, 44c, 45/c, 55/c, 57/c, 58/b, 59/b, 60/c, 61/b, 62, 63/b, 64/c, 65/d, 66/b, 67/c, 76/d, 77/c, 84/c, 94/d, 95/c, 96/d, 103/b, 104/c, me nje siperfaqe totale 167.25 ha. Ekonomia pyjore "Livadh-Hamzi" ngastrat/nengastrat 3/b, 4/b, 14/b, 15/b, 16/d, 17/c, 21/a, 22/a, 28/e, 29/d, 33/b, 34/c, 35/e, 36/c, 37/c, 38/a, 39/b, 40/c, 41/b, 42/c, 43/b, 44/c, 48/c, me nje siperfaqe totale 190.25 ha. Ekonomia pyjore "Gojan-Shkoze" ngastra 8/a, sip. totale 13.5 ha. Ekonomia pyjore "Gomsiqe" ngastrat/nengastrat 40, 41/a, 67, 68, 69/a, 70/a, 76, 91/b, 92/b, 93, 94, 95/a, 96/a, 97/b, 105/a, 118/a, sip. totale 684.25 ha. Ekonomia pyjore "Kryezi-Bicaj" nengastrat 18/b sip. totale 2 ha, sipas relacionit dhe hartave bashkengjitur vendimit. **Ne total siperfaqja eshte 1069.39 ha.**

Per shfrytezimin e ketyre sip. kullosore te zbatohet VKM nr. 632, dt. 11.06.2009 “Per miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje”

Per vazhdimn e proçedurave sipas percaktimeve te Udhezimit nr. 2/2016 te Ministrise se Mjedisit, ngarkohet Seksioni i Pyjeve dhe Kullotave ne Bashkine Puke.

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe Seksioni I Pyjeve dhe Kullotave

2. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr. 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”.

3. Shpallur me date **25.03.2024**

4. Miratuar me 11 vota pro,Vota Pro 11, Vota Kunder 0 , Vota Abstenim 0 .

SEKRETARE

Edona **HYSENAJ**



KRYETARI I KESHILLIT

Eduard **GJOKA**



1.04.24

12.04.2024
Për veprimin
K. Mulla

630/4
11.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 246/1 prot.

Shkoder, më 8.04.2024



Lënda: Mbi vendimin nr. 9, datë 18.03.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 4, të ligjit nr. 9693, dt. 19.03.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar, neni 15, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, të ndryshuar, pika 50, shtojca 48, të VKM nr. 632, datë 11.06.2019 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje", të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari", të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë nr. 642/3 prot., datë 25.03.2024 "Dokumentacioni shoqërues i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Pukë të datës 18.03.2024", shqyrtoi *VKB Pukë nr. 9, datë 18.03.2024 "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari për vitin 2024"*.

Me anë të kësaj vendimarrjeje Këshilli Bashkiak është shprehur në parim, për dhënien e kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive e për kositje bari sipas listës së miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Relacionin nr. 630/1 prot., datë 11.03.2024 "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje për sezonin 2024" të sektorit përgjegjës për pyjet në bashki. Për sa më sipër, për çdo kërkesë për marrje me qira kullote apo livadhi sipas listës së miratuar, duhet që Këshilli Bashkiak të shprehet me një vendimarrje të veçantë.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

